

**VENDIM**  
**Nr. 822, datë 26.11.2014**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, NDËRMJET PROGRAMEVE NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, shpenzime kapitale, shtohet fondi prej 149 000 000 (njëqind e dyzet e nëntë milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, shpenzime kapitale, zbritet fondi prej 115 000 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 09240 “Arsimi i mesëm profesional”, shpenzime kapitale, zbritet fondi prej 27 100 000 (njëzet e shtatë milionë e njëqind mijë) lekësh.

ç) Në programin buxhetor 01110 “Planifikim menaxhimi”, shpenzime kapitale, zbritet fondi prej 4 900 000 (katër milionë e nëntëqind mijë) lekësh.

d) Në programin buxhetor 08140 “Programi për sportin”, shpenzime kapitale, zbritet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**